



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

Studim: “Ndikimi i sipërfaqes gjethore në cilësinë e prodhimit në kulturën e kajsisë”.

Kultivarët në studim: Bulida, San Castresse, Pellechiella

Vendi i ngritjes së studimit: Baza Eksperimentale prodhuese Shamogjin.

1. Hyrje

Kajsia është një bimë që kërkon vëmendje të veçantë për një prodhim cilësor. Meqënëse frutat e kajsisë dalin shpejt në treg (fondi i muajit maj), edhe pse në shumë raste shuma e temperaturave deri në periudhën e pjekjes nuk është e lartë duke rrezikuar kështu një prodhim jo shumë cilësor për nga ana e karakteristikave organo-leptike.

Në pemët frutore raporti midis masës gjethore e asaj drunore është i ndryshëm. Kjo varet nga shumë faktorë si: cilësitë e kultivarit shërbimet agroteknike toka në të cilën është mbjellë etj.,

Faktori kryesor i masës gjethore në pemë është krasitja dimërore dhe krasitja e gjelbër e cila është nga operacionet me delikate dhe më të rëndësishme për të patur një prodhim cilësor. Për të bërë një vlerësim të ndikimit të sipërfaqes gjethore mbi cilësinë e prodhimit në parcelat e prodhimit të Bazës Eksperimentale Shamogjin, në kultivarët, Bulida San Castresse dhe Pellechiella u ngritën disa prova

2. Metodologjia e përdorur

Studimi u ngrit në formën e provave, në kultivarët: Bulida, San Castresse dhe Pellechiella

1. Prova e parë: Pa ndërhyrje (pa rrallim të lastarëve) duke lënë në bimë gjithë sasinë e lastarëve
 2. Prova e dytë: Rrallim i lastarëve në momentin kur kanë arritur 20-30 cm gjatësi.
 3. Prova e tretë: Rrallim i lastarëve në momentin kur kanë arritur mbi 50-60 cm gjatësi.
- Për çdo kultivar u zbatua e njëjta skemë duke i marrë si prova krahasuese (3) brenda kultivarit. Numri i bimëve marrë në studim dhjetë (10) bimë për çdo provë.

Treguesit e marrë në analizë:

- Vëzhgimet fenologjike
- Analiza pomologjike
- Fuqia e zhvillimit të bimës
- Matja e sipërfaqes gjethore për çdo kultivar
- Analizat kimike për përqindjen e sheqerit, aciditetin.

3. Rezultate dhe diskutime

Vëzhgimet fenologjike.

Kultivari *Bulida*

Periudha e lulëzimit është 6-10 Mars.

Lulëzimi i plotë deri në lidhjen e kokrrës deri në 4 Prill
Ditët nga lulëzimi i plotë deri në pjekje janë 89-92 ditë
Pjekja e kultivart Bulida varion nga data 24.05 -10.06

Kultivari *San Castrese*

Periodha e lulëzimit është 16-20 Mars.

Është marrë fillim lulëzimi, kur pema ka lulëzuar në masën 10 - 15%.

Lulëzim i plotë kur ka lulëzuar mbi 75 % e pemës.

Kultivari *Pellechiella*

Periodha e lulëzimit deri në lidhjen e kokrrës varionte në datat 6 Mars deri në 5 Prill.

Ditët nga lulëzimi i plotë deri në pjekje rezultojnë të jetë midis 117 -120 ditë.

Analiza pomologjike. Heqja e lastareve në gjatësi të ndryshme nuk shënuan dukshëm rrënjësore.

Rralimi kishte ndikim në rritjen e qëndrueshmërisë së frutave në Kajsi.

Frutat në provën ku rralimi i degëve u bë në gjatësinë 50-60 cm ishin më të qëndrueshëm se në provën e rralimit në masën 15-20 cm dhe provën ku nuk u krye rralimi.

Aplikimet e rralimit të lastarëve në gjatësi prej 50-60 cm, kishin efekt të rëndësishëm në theksimin e ngjyrës tipike të kultivarit.

Analiza e Volumit të kurorës sipas Kultivarëve

	Bulida	Pellechiella	San Castrese	Mesatarja	Klasa
2016	54.34	45.987	92.312	552.1598	ab
2017	62.21	53.32	99.11	557.91	a

Në treguesin e rritjes së volumit të kurorës analiza e të dhënave, kultivari San Castrese ka rritjen më të madhe të kurorës në krahasim me dy kultivarët e tjerë Pellechiella dhe Bulida.

Kultivarët Bulida dhe Pellechiella nuk kanë ndryshime të vërtetuara midis tyre.

3. Sipërfaqja gjethore

Matja e sipërfaqes gjethore u realizua me programin Leafarea për çdo lastar (mm²).

Bulida A 107.27503

Pellechiella A 81.15626

San Castrese A 66.90548

Analiza e sipërfaqes gjethore midis provave në kultivarët Bulida, San Castrese dhe Pellechiella sipas analizës statistikore për nivelin e gabimit 0.05 nuk ka ndryshime të vërtetuara statistikore.

Kultivarët nuk kanë të njëjtën mënyrë rritjeje vegetative e për pasojë kanë edhe formë të ndryshme të kurorës. Në të gjithë kultivarët është aplikuar e njëjta mënyrë krasitje.

Nisur nga vlerësimi agronomik i sipërfaqes gjethore sipas pozicionimit të degëve tregojnë se në rastin e kultivarit (figura. 3) kultivari San Castrese ka një shtrirje më të gjerë të degëve kundrejt ndriçimit diellor duke patur kështu një zhvillim më të madh të fotosintezës dhe për rrjedhojë

përpunon një sasi më të madhe të lëndëve ushqyese e cila ndikon në një prodhim më të madh e cilësor.

Sasia e prodhimit është më e lartë tek kultivari San Castrese në lidhje me kultivarët Bulida dhe Pellechiella dhe cilësia e prodhimit po ashtu pasi në treguesit kimik kultivari San Castrese rezulton më i miri.



Figura Nr. 1
Kultivari Bulida (natyra e rritjes së kurorës, fruti)



Figura Nr. 2
Kultivari Pellechiella (natyra e rritjes së kurorës, fruti i pa maturuar)



Figura Nr. 3
Kultivari San Castrese (natyra e rritjes së kurorës, fruti)

Të dhëna për frutin për vitet 2016-2017.

Në momentin e pjekjes janë realizuar pesha e frutit, sasia e prodhimit të marrë për çdo bimë, si dhe janë kryer analizat kimike të frutit sipas kultivarëve (lënda e thatë, përqindja e sheqerit dhe e aciditetit).

Disa nga treguesit po i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 1 Koha e pjekjes, pesha e frutit dhe prodhimi kg/bimë për vitet 2016-2017

Kjo fenofazë nuk ka ndryshime të rëndësishme e cila tregon për stabilitetin e kultivarëve

Kultivari	Viti 2016	Pjekja	Pesha mesatare e frutit (gr)	Prodhimi (Kg/bimë)
Bulida		24/5-5/6	80	24.15
Pellechiella		20.6-30.6	92	33.59
San Castrese		10.6-20.6	95	36.86
	Viti 2017			
Bulida		30/5-10/6	76	36
Pellechiella		25/06-5/07	85	50
San Castrese		18/06-30/06	90	61.5

Tabela Nr. 2 Vlerat e përqindjes së sheqerit dhe aciditetit për tre kultivarët në momentin e vjeljes.


Provat	Viti 2016	Prova 1			Prova 2			Prova 3		
		Lënda e Thatë	% sheq.	Acidi teti	Lënda e Thatë	% Sheq.	Acidi teti	Lënda e Thatë	% Sheq.	Aciditeti
Bulida		12.6	9.91	1.76	11.4	7.95	1.67	13.2	10.44	1.44
Pellechiella		11.96	9.93	1.73	11.2	8.00	1.64	13.2	10.5	1.42
San Castrese		12.1	9.96	1.71	11.00	8.12	1.62	13.12	10.9	1.42
	Viti 2017									
Bulida		12.8	10.35	0.90	12.3	9.05	1.11	13.5	11.25	1.21
Pellechiella		12.57	10.12	1.16	12.25	9.32	1.31	13.4	10.98	1.15
San Castrese		12.20	9.98	1.45	12.34	9.54	1.15	10.54	10.23	1.12

Rendimenti më i lartë për pemë (kg) duke marrë parasysh mesataren dy vjeçare është marrë nga kultivari San Castrese.

Kultivari	Viti 2016	Prodhimi (Kg/bimë) Prova 1	Prova 2	Prova3
Bulida		18.9	22.8	24.15
Pellechiella		22.1	25.6	33.59
San Castrese		29.5	27.5	36.86
	Viti 2017			
Bulida		22.1	24.9	36
Pellechiella		26.3	27.4	50
San Castrese		30.4	34.8	61.5

Tabela Nr. 3 Prodhimi mesatar për çdo kultivar

Kultivari	Viti 2016
Bulida	
Pellechiella	
San Castrese	
	Viti 2017
Bulida	
Pellechiella	
San Castrese	



Konkluzione

- Rrallimi i lastarëve është parë si një mundësi për një raport të drejtë midis ngarkesës së prodhimit dhe rritjes së cilësisë në këto prova aplikimi. Rrallimi kur lastarët kanë arritur gjatësinë 20-30 cm, bëhet kur ngarkesa e bimës me masë gjethore nuk është shumë e madhe. Në këtë moment kryerja e këtij operacioni është më i lehtë pasi lastarët eliminohen pa përdorur gërshërën e krasitjes duke siguruar edhe më pak plagë në bimë.

- Në rastin e rrallimit të lastarëve në gjatësi 50-60 cm bima ka mundësi për një ajrosje më të mirë dhe një shpërndarje uniforme të masës gjethore. Sipërfaqja gjethore nuk ka pasur diferenca të mëdha brenda provave dhe pse kanë formë të ndryshme të kurorës.

Rekomandime

1. Largimin e një pjese të masës gjethore (kur lastarët kanë aritur lartësinë 50 -60 cm) duke krijuar kështu mundësinë e bimës të ketë një ajrosje e ndriçim më të mirë.

2. Rrallimin e lastarëve që dalin brenda kurorës duke bërë të mundur që prodhimi të jetë uniform në të gjithë kurorën duke qenë më i ekspozuar nga dielli që do të ndikoj në rritjen e cilësisë së prodhimit.

Literatura

1. Dokoozlian.N. 2010. Gestione integrata della chioma: venti anni di evoluzione nella viticoltura californiana. Review n. 12 - Italus Hortus 17 (4).
2. Dokoozlian N.K., Kliewer E. M., 1995a. The light environment within grapevine canopies. I. Description and seasonal changes during fruit development. Am. J. Enol. Vitic. 46: 209-218.
3. Dokoozlian N.K., Kliewer E.M.,1995b. The light environment within grapevine canopies. II. Influence of leaf area density on fruit zone light environment and some canopy assessment parameters. Am. J. Enol. Vitic. 46: 219-226
4. James M. Meyers., Justine E. Vanden Heuvel., 2008. Enhancing the Precision and Spatial Acuity of Point Quadrat Analyses via Calibrated Exposure Mapping. Am. J. Enol. Vitic. 59:4.
5. Gladstone E.A., Dokoozlian N.K., 2003. Influence of leaf area density and trellis/training system on the light microclimate within grapevine canopies. Vitis: 42:123-131
6. Kliewer E.M., Dokoozlian N.K., 2001. Leaf area/crop height ratios of grapevines: Influence on fruit composition and wine quality. Proc. ASEV 50th Anniversary Annual Meeting.J.M. Rantz (Ed): 285-289.
7. Modello di gestione integrata per la sostenibilità del vigneto[Pub. med]
8. Manni E., Bravetti B., Lanari V., Lattanzi T., Silvestroni O.2010. Influenza del diradamento dei germogli sulla composizione delle chiome e delle uve di Montepulciano. Fondazione E.Mach. Convegno nazionale della viticoltura.
9. Miele S., Marmugi M., Bargiacchi E., Foschi L. Evoluzione della tecnologia produttiva nel vigneto Gestione agronomica del suolo e nutrizione vegetale[Pub. med]
10. Akcay M.E., 2001. The effect of pruning on growth, yield and quality in sweet cherries. Proceedings of 1st stone Fruits Symposium, Yalova Turkey, p. 153–159. Anonymous., 2008. Food and Agricultural Organization. www.fao.org. AOAC., 1984. Official methods of analysis (14th ed.). VA, USA: Association of Official Analytical Chemist, Arlington.
11. Barden J.A., Marini R.P., 1984. Summer and dormant pruning of apple – a four year summary. Acta Hort. 146, 263–268. Barnalte M.J, Sabio E., Hernandez M.T., Gervasini C., 2003.

Influence of storage delay on quality of "Van" sēet cherry. Post. Biol. Technol. 28, 303–312.
Carlson R.F., 1982. Fruit tree training and pruning. Compact Fruit Tree, 15, 96–98. Chitkara S.D., Arora R.K., Sharma R.K., 1991. Effect of various levels of pruning on yield and fruit quality in Flordasun peach. Haryana J. Hort. Sci. 20, 189–192.

12. Christopher S.Ē., Allnutt F.J., Miller A.N., Thompson A.H., 1989. Nitrogen level and time of mechanized summer shearing influence long-term performance of a high-density "redskin" peach orchard. J. Amer. Soc. Hort. Sci. 114, 373–377. Cust C.R., Ferree D.C., 1985. Time and severity of summer pruning influences on young peach tree net photosynthesis, transpiration, and dry ēight distribution. J. Amer. Soc. Hort. Sci. 110, 455–461

Pērgatiti:

Athina Llambro

Adhurim Lazaj

Ornela Boçova

Dhjetor 2017